

SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-013/2014

Prishtinë, 14 Tetor 2015

Në çështjen juridike të:

B.S.

ne emër të bashkëshortes T.S.

Kosanciceva 23/3

Cuprija, Serbi

**Pala ankuese**

kundër

N.S.

Kabash,

Viti

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetari i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, mbi ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KPCC/D/A/156/2012, të datës 6 qershor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numër 06415), pas shqyrtimit të mbajtur më 14 Tetor 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

**Hidhet si e pasafatshme ankesa e B.S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/156/2012, të datës 6 qershor 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër 06415.**

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 16 janar 2007, B.S.S. (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës), si anëtar i familjes, ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 3375, që ndodhet në Shigoje, komuna e Vitisë (ngastra e kërkuar). Ai ka thënë se gruaja e tij e ka trashëguar pronën e kërkuar nga i ndjeri babai i saj, si bashkëpronare me motrën e saj.
2. Në mbështetje të kërkesës së tij, ai ka dorëzuar në AKP dokumentet në vijim:
  - a) Certifikatën e martesës nr. 202-2007-V, të datës 17 shtator 2007, të lëshuar nga Zyra Civile në komunën e Vitisë, ne te cilën konstatohet marrëdhënia në mes të paraqitësit të kërkesës dhe T.Z. ;
  - b) Aktvendimin për trashëgiminë T.nr. 32/05, të datës 31 maj 2005, të Gjykatës Komunale në Viti; me këtë vendim, gruaja e paraqitësit të kërkesës është e shpallur si trashëgimtare e ngastrës së kërkuar së bashku me motrën e saj S.V., me pjesë ideale prej 1/2;
  - c) Aktgjykimin C.nr. 202/2003, të datës 22 maj 2008, të Gjykatës Komunale në Viti; me këtë aktgjykim kontrata për shitblerje të ngastrës së kërkuar, ku përmendet D.Z. (babai i bashkëshortes së paraqitësit të kërkesës) si shitës dhe F.H. si blerës, shpallet e pavlefshme.
3. Kërkesa është regjistruar në AKP me numër KPA06415.
4. AKP-ja i ka verifikuar pozitivisht dokumentet.
5. Njoftimi fizik i kërkesës është bërë më 22 janar 2010, duke vendosur një shenjë në pronën e kërkuar. Nga njoftimi është gjetur se prona është tokë kultivuese dhe e uzurpuar.
6. Kërkesa është kontestuar nga N.S. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë). Ai është paraqitur në AKP si palë përgjegjëse në kërkesë. Më 2 mars 2010, ai ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje dhe ka kërkuar të drejtë ligjore ndaj pronës së kërkuar. Ai ka thënë se e ka blerë ngastrën e kërkuar nga familja H. Familja H e ka blerë pronën e kërkuar nga F.H.. Për t'i mbështetur pretendimet e tij, ai ka paraqitur dokumentet në vijim:

- Certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme nr.UL-70101007-3371, të datës 5 gusht 2005, të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Viti. Sipas kësaj certifikatengastra e kërkuar është regjistruar në emër të palës përgjegjëse në kërkesë N.S. ;
  - Kontratën e shitblerjes Vr. 660/02, të datës 29 gusht 2002, e lidhur në mes të D.Z., vjehrrit të paraqitësit të kërkesës dhe F.H.; kjo është kontrata e cila ishte çështje lëndore në procedurë, si dhe e anuluar, që përmendet më lartë në paragrafin 2.c;
  - Një marrëveshje formale e shkruar me dorë e datës 6 gusht 2004, që tregon se pala ankuese ka blerë ngastrën e kërkuar nga familja H.
7. Në raportin e verifikimit, të datës 19 tetor 2011, ekipi i AKP-së ka vërtetuar se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të dy bashkëpronarëve. AKP-ja, ex-officio, ka gjetur këto dokumente:
- Certifikatën për pronën e paluajtshme nr.UL-70101007-03243, të datës 18 tetor 2011, të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Viti, e cila liston T.S. si pronar të 1/2 së ngastrës së kërkuar.
8. KKPK-ja me vendimin KPPC/D/A/156/2012, të datës 6 qershor 2012, ka vendosur ta hedhë poshtë kërkesën me arsyetimin (në paragrafët 11 dhe 97-99) se kërkesa është *res judicata*, sepse për të njëjtin kontest është vendosur tashmë nga Gjykata Komunale në Viti. Në aktgjykimin e lartpërmendur në paragrafin 2.c. KKPK-ja shpjegon se kontrata e lidhur në mes të vjehrrit të paraqitësit të kërkesës dhe paraardhësit të palës përgjegjëse në ankesë, F.H., është shpallur e pavlefshme. Në bazë të këtij aktgjykimi prona e kërkuar është bartur në emër të bashkëshortes së paraqitësit të kërkesës dhe motrës së saj.
9. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës, B.S. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), më 5 mars 2013 dhe palës përgjegjëse në ankesë më 20 mars 2013. Pala ankuese ka paraqitur ankesë më 9 tetor 2013. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 20 janar 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese:**

10. Pala ankuese e kundërshton vendimin e KKPK-së si të pasaktë dhe ka kërkuar nga Gjykata Supreme që ta korrigjoj vendimin dhe të marrë një vendim tjetër në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ankesë.

### **Arsyetimi ligjor:**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

11. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, (në tekstin e mëtejme Ligji i UNMIK-ut 2006/50) parasheh se: “*brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i*

*palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e [AKP-së] për një kërkesë, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.*

12. Duke qene se vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 5 mars 2013, pala ankuese duhet te paraqiste ankesë brenda afatit 30 ditor te parashikuar ne dispozitën e lartpermendur. Pala ankuese ka paraqitur ankesë më 9 tetor 2013. Që është jashtë afatit te parashikuar ne ligj. Prandaj, ankesa duhet të hidhet poshtë si e pasafatshme (neni 13.3 i Ligjit të UNMIK-ut nr. 2006/50).

13. Për me tepër, paraqitësi i ankesës nuk ka dhënë shkaqe te arsyeshme për vonesën. . Ai ishte njoftuar mjaftueshëm për afatin e fundit, pasi vendimi përmbante një paralajmërim për këtë afat në gjuhën serbe.

14. Prandaj, ankesa duhet të hidhet poshtë në baza procedurale si e pasafatshme në pajtim me nenin 13.3 nën-paragrafi (b) i Ligjit të UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 195.1 (a) dhe 196 i Ligjit të Procedurës Kontestimore.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**